



## **Fillimi i negociatave dhe rruga me shumë të panjohura**

### **Neritan Sejmini**

Shumë e panë nisjen e negociatave për anëtarësimin në BE si fillimin e një rruge që shpejt do na çojë në Bashkimin Europian. Unë e shoh si fillimin e një rruge që nuk dihet se ku do të na çojë.

Fillimi i negociatave është fundi i trysnisë apo detyrimit politik të BE-së për të na “dhënë” diçka, me qëllimin të na mbajë gjallë shpresën e anëtarësimit, pa na anëtarësuar, por mjaftueshëm edhe për të na mbajtur satelite” të Perëndimit.

Në BE mendojnë se negociatat me Shqipërinë do jenë një proces i stërgjatë, 15, 20, 25 vjeçar. Ka në BE jo pak që mendojnë apo duan që Shqipëria të mos bëhet pjesë asnjëherë—kjo shpjegon edhe nismat apo përpjekjet e herëpashershme për të gjetur një tjetër formulë “afrimi pa anëtarësim” për Shqipërinë e vendet e mbetura.

Sidoqoftë, një gjë është e qartë: BE nuk ka më trysninë të na “japë” diçka për të treguar se na duan pranë. Nëse përkushtimi i tyre do të vihet në dyshim, ata përmendin negociatat si prova që na duan në BE, por duke na bërë të qartë se përparimi i negociatave nuk është në dorën e tyre, por në tonën.

Një gjë që BE e di mirë, ne do ta mësojmë tani: realiteti ynë social, ekonomik dhe politik është shumë larg realitetit dhe standardeve të BE-së. Këtë largësi, deri më sot, ne nuk e kemi perceptuar qartë, ndoshta të verbuar nga shpresa apo dëshira jonë e zjarrtë, apo të influencuar nga propaganda politike me ‘integrim europian’.

Në fakt, në tre dekadat e fundit edhe pse në terma objektivë ne jemi më pranë BE-së, në sytë e tyre ne kemi ardhur duke u larguar. Ne nuk kemi reflektuar asnjëherë se pse na u deshën më shumë se 30 vjet vetëm për të filluar negociatat, ndërkohë që vende që e nisën si ne, si për shembull Polonia apo Sllovakia, kanë thujse dy dekada që janë anëtare të BE-së. Në fillim ne kishim të njejtën perspektivë si ato, të paktën teorikisht.

Pak e dinë sot, por në fillim të viteve 1990-të, Shqipëria shihej nga komuniteti ndërkombëtar si vendi ideal për të zbatuar një tranzicion të shpejtë dhe të suksesshëm drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut, pasi ajo paraqiste përparësi teorike ndaj vendeve të tjera: ishte një vend me popullsi të vogël dhe homogjene, pa probleme etnike, pa probleme nacionalizmi agresiv, pa konflikte me vende të tjera, me pozicion gjeografik të shkëlqyer, me burime të mëdha natyrore, dhe me popullsinë me moshën më të re në Evropë.

Në fakt, që në vitin 1991 Shqipëria u përfshi në të njejtin grup me Poloninë, Hungarinë, Çekinë, Sllovakinë e Vendet Balltike në trajtimin nga BE dhe pjesë njësoj si to e të njejtin program asistence për ristrukturimin dhe anëtarësim (Programi PHARE).

Sukseset e shpejta të reformave të para të liberalizimit ekonomik dhe trumbetimi asokohe i Shqipërisë nga FMN-ja si model sukcesi i transformimit ekonomik—ishite koha kur Shqipëria shënoi për disa vite rritjen më të lartë ekonomike në Europë, në disa vite me dy shifra—e përforcuan këtë pritshmëri.

Ndërkohë, dëshira e madhe e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e aleancave perëndimore—Shqipëria ishte, për shembull, vendi i parë ish-komunist që aplikoi për t'u bërë anëtare e NATO-s në vitin 1992—shiheshin si garanci politike që Shqipëria nuk do të ndalej në rrugëtimin e saj drejt Europës e perëndimit.

Por ecuria e mëpasme tregoi se pritshmëritë për Shqipërinë ishin të ekzagjerura. Shqipëria filloi rënien në shkallën e prioritetëve të zgjerimit të BE-së. Fillimisht, ajo u shkëput nga Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia duke u rigrupuar me vendet balltike, Estoninë, Letoninë dhe Lituaniën, në trajtimin nga BE-ja. Kur këto vende përparuan, ajo u grupua me dy vendet ballkanike që përparuan menjëherë pas shkëputjes nga ish-Jugosllavia, dhe më pas, Slloveninë dhe Kroacinë.

Pasi edhe ato ecën përpara dhe u bënë vende candidate, Shqipëria u përfshi nën një grupim të ri—me një emërtim të sajuar enkas për t'u dukur i bukur, Ballkanin Perëndimor—me Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnje-Hercegovinën. Madje edhe në këtë grupim, Shqipëria është në rreshtin e dytë, pasi Serbia dhe Mali i Zi janë vite përpara në negociata, ndërsa Maqedoninë e Veriut e mbajti në vend Greqia për disa vjet. Praktikisht, ne lëmë pas Kosovën dhe Bosnjën si vendet e fundit në listën e prioritetëve të zgjerimit të BE-së.

Kjo mbetje prapa në procesin e anëtarësimit, paradoksalisht, do vijë e do bëhet me e dukshme tani që ne po negociojmë anëtarësimin. Mund të kete shumë shpjegime dhe teori për vonesat tona në integrimin europian, por pavarësisht atyre mendoj se ka një gjë thelbësore që na ka mbajtur pas: ne nuk kemi krijuar ende kulturën e duhur politike dhe sociale për të qenë pjesë e BE-së. Në të vërtetë, për ne integrimi europian më shumë se i nxitur nga vlerat, ka qenë i motivuar nga 'racionalizmi instrumental': ne e kemi parë BE-në në mënyrë pragmatike, si një instrument për të arritur nga një shteg i shkurtër mirëqenien dhe standardet që nuk i arrijmë dot apo nuk duam t'i arrijmë dot vetë. E thënë ndryshe ne e duam BE-në për të përfituar, por jo se ndajmë të njëjtat vlera sociale apo politike me të.

Në thelb, Bashkimi Europian është një komunitet vlerash dhe ligjesh, në themel të të cilit janë të drejtat dhe dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, demokracia pluraliste, tolerance.

Për të përqaftuar këto vlera dhe ëpr të arritur ekto standarde shoqërore nuk ka nevojë për të qenë pjesë e BE-së. Ne nuk na ka penguar mosqenia në BE për t'i arritur këto vlera. Nuk është mosqenia në BE burimi i shkeljes së të drejtave të njerut, veçanërisht të së drejtës së pronës, sikurse nuk është ky shkak për autokracinë e rënien e demokracisë, korrupsionin e kudondodhur, pabarazinë para ligjit që sundojnë në Shqipëri.

Ne nuk duam të punojmë për të arritur këto vlera, kërkojmë që BE t'i anashkalojë ato, dhe të na bëjë pjesë të saj, dhe kështu ne do përfitojmë nga mirëqenia materiale dhe personale që mendojmë se buron nga anëtarësimi. Ndërkohë që BE kërkon që ne të përparojmë në përqaftimin e këtyre vlerave që pastaj të na anëtarësojë.

Ka nga ata që mendojnë se BE duhet të bëhet më pak e rreptë në këto standarde, sikurse ajo ka bërë për vendet e tjera të Europës Lindore si për shembull Bullgaria, nga e cila ne nuk ndryshojmë aq shumë. Por ironikisht sepse BE u tregua më pak e rreptë në këto raste dhe u zhgënjye ajo tashmë është edhe më e rreptë se më parë në kërkesat ndaj standardeve dhe kriterëve politike dhe shoqërore.

Prandaj, mendoj se procesi ynë i negocimit do të jetë më shumë imponim evropian se sa negocim evropiano-shqiptar. Për herë të parë ne do na duhet të sillemi si evropianë që të bëhemi politikisht evropianë. Nëse nuk do sillemi si evropianë, negociatat për anëtarësim do të jenë thjesht një rrugë që nuk çon asgjëkund.

*Ky shkrim është pjese e serise se shkrimeve "Media dhe Integrimi European", te Institutit Shqiptar te Medias, ne kuadrin e Programit te Promovimit te Tranzicionit te Republikes Ceke.*